

# Drejtësia miqësore për fëmijët – Lista e plotë për profesionistët



## Çfarë veprimesh duhet të ndërmerren që procedimet të jenë miqësore për fëmijët?

*A do të jetë në gjendje fëmija që të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj për t'u dëgjuar?*

- Duhet përshtatur kushtet për t'u siguruar që fëmija dëgjohet.
- Profesionistët duhet të pranojnë në mënyrë të qartë këtë të drejtë gjatë të gjitha procedimeve

*A po merr fëmija mbështetje profesionale dhe personale?*

- Mbështetja profesionale mund të përfshijë punonjësit socialë dhe psikologët.
- Person i besuar.



*Si mund të informohet fëmija për procedimet dhe të drejtat e tij apo të saj?*

- Përmes informacionit më gojë dhe me shkrim.
- Informacioni i përshtatur me moshën e fëmijës, pjekurinë, nivelin e të kuptuarit dhe vështirësitë e komunikimit.
- Material vizual.




### Si mund të përgatitet një fëmijë për seancën dëgjimore?

- Personi mbështetës duhet të kontrollojë që:
  - fëmija ndihet se është informuar siç duhet për të drejtat e tij/saj;
  - fëmija di se çfarë të presë gjatë procedimeve.
- Përgatitja duhet të fillojë pak para fillimit të seancës dëgjimore.
- Duhet mbajtur takimet përgatitore miqësore për fëmijët dhe vizitat.
- Nevojat e tyre të posaçme duhen identifikuar.



### Për çfarë duhet të pyetet fëmija përpara seancës dëgjimore?

- A janë të përshtatshme vendi dhe ora për fëmijën?
- Kush duhet ta shoqërojë fëmijën si person i besuar i tyre?
- A ekzistojnë persona që duhet të marrin pjesë në seancën dëgjimore?
- A kanë nevojë për masa mbrojtëse?
- Kush duhet ta mbajë seancën dëgjimore?
  - Gjinia dhe profesioni janë jetësore.




### Çfarë siguron kontrolli i këtyre hollësive?

- Fëmija mund të ndikojë se si kryhet seanca dëgjimore e tyre.
- Fëmija mund të njohë çdo person që kryen seancën dëgjimore.

### Cilat masa përpara seancës dëgjimore ndihmojnë në bërjen e kësaj seance miqësore për fëmijët?

- Dhënia e udhëzimeve që kanë lidhje me sjelljen.
- Një kohë pritjeje të shkurtër pas mbërritjes dhe para seancës dëgjimore.
- Pasja e një zone pritëse miqësore për fëmijët.



### Cilat masa gjatë seancës ndihmojnë në bërjen e kësaj seance miqësore për fëmijët?

- Një sallë seancash miqësore për fëmijët që ndodhet jashtë gjykatës.
- Sjellja miqësore për fëmijët nga ana e të gjithëve.
- Një numër i vogël i personave të pranishëm në seancën dëgjimore.
- Mungesa e të pandehurit apo palëve të tjera.
- Një person që dëgjon fëmijën.
- Gjuha e përshtatur për moshën dhe pjekurinë e fëmijës.
- Përdorimi i teknikave të përshtatshme të bërjes së pyetjeve.
- Seanca të shkurtra, me një kohëzgjatje maksimale prej një ore.



### **Cilat masa pas seancës ndihmojnë në bërjen e seancës miqësore për fëmijët?**

- Fëmijës i shprehet mendimi dhe i jepet informacioni për hapat që pasojnë.
- Të gjithë profesionistët e përfshirë janë dakord për vijimësinë.




Fëmija



Faza pas gjyqit

### **Çfarë mund të bëhet për të shmangur mbajtjen e disa seancave?**

- Vini në dispozicion regjistrime me video për mbledhjen e provave (çështjet penale).
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit mes të gjithë grupeve profesionale të përfshira.




### **Nëse një seancë nuk është e mjaftueshme, profesionistët duhet të jenë të vetëdijshëm që gjatë seancave të mëtejshme:**

- Një marrëdhënie besimi me profesionistët është shumë më e rëndësishme dhe se seanca duhet mbajtur nga i njëjti profesionist.
- Pyetjet nuk duhet të jenë përsëritëse.
- Informacioni përkatës duhet ndarë me profesionistët.

### **Për çfarë nevojitet vijimësia?**

- Mbështetje e mëtejshme për fëmijën dhe familjen.
- Informimi dhe shpjegimi i vendimeve dhe mbështetjes së mundshme në të ardhmen.
- Kohët e shkurtra mes seancës dhe vendimit; vendimi i shoqëruar nga informacioni.



### **Po nëse nuk ndiqet vijimësia?**

- Procedimet mund të përfundojnë vetëm nëse vijimësia është e sigurt dhe raportohet.



Rreth 2,5 milionë fëmijë marrin pjesë çdo vit në procedime gjyqësore në të gjithë Bashkimin Evropian (BE), të prekur nga ndarja e prindërve apo si viktime, apo dëshmitarë të krimet. Megjithëse pjesëmarrja e tyre e efektshme në të tilla procedime është jetësore për përmirësimin e funksionalitetit të drejtësisë. Trajtimi i fëmijëve në sistemet gjyqësore mbetet një shqetësim. Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore (ADTh) kreu hetime për të gjetur se në cilën masë dëgjohej, informohen, mbrohen të drejtat e fëmijëve dhe në cilën masë zbatohen pa paragjykimë në praktikë. Ky hetim përfshin edhe intervista të gjata me profesionistë dhe fëmijë të përfshirë në procedime gjyqësore. Raporti i parë paraqiti mendimet e profesionistëve. Raporti aktual fokusohet në perspektivën e fëmijëve, paraqitjen e mendimeve të tyre për faktorët që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe për përpjekjet që mund të ndihmojnë në tejkalimin e këtyre pengesave. Ashtu si raporti i parë, ky raport thekson se mbetet ende shumë për t'u bërë për ta bërë drejtësinë në gjithë BE-në me të vërtetë miqësore për fëmijët.

## Informacion i mëtejshëm

Shikoni raportet dhe faqen në internet të ADTh-së për drejtësinë miqësore për fëmijët:

- ADTh-ja (2017), *Drejtësia miqësore për fëmijët – Perspektivat dhe përvojat e fëmijëve të përfshirë në procedime gjyqësore, si viktime, dëshmitarë apo palë në nëntë Shtetet Anëtare të BE-së*, Luksemburg, Zyra e Botimeve;
- ADTh-ja (2017), *Drejtësia miqësore për fëmijët – perspektivat dhe përvojat e fëmijëve dhe profesionistëve*, Përmbledhje, Luksemburg, Zyra e Botimeve (do të botohet në 24 gjuhë të BE-së);
- ADTh-ja (2015), *Drejtësia miqësore për fëmijët – perspektivat dhe përvojat e profesionistëve për pjesëmarrjen e fëmijëve në procedimet penale dhe civile gjyqësore në 10 vende të Shteteve Anëtare të BE-së*, Luksemburg, Zyra e Botimeve, dhe përmbledhja, <http://fra.europa.eu/en/publication/2015/child-friendly-justice-perspectives-and-experiences-professionals-summary> (e disponueshme në 24 gjuhë);
- <http://fra.europa.eu/en/theme/rights-child>.

### FRA – AGJENCIA EVROPIANE PËR TË DREJTAT THEMELORE

Schwarzenbergplatz 11 – 1040 Vjena – Austria  
Tel. +43 1580300 – Fax +43 158030699  
[fra.europa.eu](http://fra.europa.eu) – [info@fra.europa.eu](mailto:info@fra.europa.eu)  
[facebook.com/fundamentalrights](https://www.facebook.com/fundamentalrights)  
[linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency](https://www.linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency)  
[twitter.com/EURightsAgency](https://twitter.com/EURightsAgency)



Publications Office

© Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore, 2018  
Ilustrimet: © FRA

